

VENDIM
Nr.1570, datë 3.12.2008

PËR DHËNIE FONDI NDIHME PARTISË “LIDHJA DEMOKRISTIANE E SHQIPËRISË (LDK)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr.8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Partisë “Lidhja Demokristiane e Shqipërisë (LDK)” t’i jepet një fond, prej 100 000 (njëqind mijë) lekësh, si ndihmë financiare.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Ngarkohet Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha